



P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **05.11.2025**, me fillim në orën **10:00**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **z. Arbër Zenuni**. Kryesuesi konstatoi se kuorumi për mbajtjen e mbledhjes ekziston. Në fillim të mbledhjes, nga 31 anëtarë, të pranishëm kanë qenë 20.

Kryesuesi: Përshëndetje për të gjithë! I nderuar Kryetar i Komunës, **z. Smajl Latifi**, nënkryetar **z. Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të kuvendit komunal, drejtorë të drejtorive komunale, zyrtarë komunalë, përfaqësues të KFOR-it, medie, të nderuar qytetarë të komunës së Rahovecit. Për këtë mbledhje të **dhjetë** me radhë dhe të fundit për legjislaturën 2021-2025, së bashku me kryetarin kemi vendosur për këtë rend dite:

R E N D I T E

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i raportit financiar, janar-shtator 2025;**
- 3. Shqyrtimi i raportit vjetor të performancës komunale 2024.**

Kryesuesi: Të nderuar kuvendarë, ju informoj që e kemi edhe një pikë shtesë: **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja urgjente për miratimin e buxhetit komunal!** Kush është “për”?... Konstatoj që unanimisht votohet pika shtesë dhe tani e vendosim në votim të gjithë rendin e ditës. Kush është “për”?... Konstatoj që unanimisht votohet rendi i ditës i mbledhjes së dhjetë.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesi: Nëse dikush ka diçka rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar?... Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Unanimisht (19) aprovohet pika e parë e rendit të ditës, gjithashtu edhe procesverbali i mbledhjes urgjente.

2. Shqyrtimi i raportit financiar, janar-shtator 2025:

Afrim Limani: I nderuar kryesues, kryetar, nënkryetar, asambleistë. Kam kënaqësi që para jush të prezantoj raportin financiar 9-mujor i Komunës së Rahovecit në fund të këtij mandati. Raporti është përbërë kryesisht prej tri pjesëve: Pjesa e të hyrave, pjesa e shpenzimit të buxhetit dhe pjesa e kontratave, janar-shtator 2025. Totali i të hyrave për këtë periudhë është 1.623.823€ dhe kur e krahasojmë me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar, atëherë kemi një diferencë pozitive prej 282.096€. Të gjobat e trafikut dhe të gjykatave janë në shumën prej 118.000€ dhe ndoshta deri më tani është periudha më e mirë e inkasimit. Në raport nuk e keni 3-mujorin e fundit, sepse është ndërruar sistemi dhe nuk kemi pasur mundësi dhe qasje t’i nxjerrim të dhënat. Shpenzimi i buxhetit në total për këtë periudhë është 18.809.000€ (84.62%). Shpenzimi në investime kapitale është 95.19%, subvencionet 84.84%, shpenzimet komunali 82.87%, mallra dhe shërbime 88.85% dhe pagat 77.25%. Në këtë proces të shpenzimit të buxhetit është edhe Kontrata Kolektive dhe ju e dini që deri më tani nga thesari janë tërhequr 2.6 milionë €. Në raport, janë gjithashtu të paraqitura edhe kontratat e lidhura (14.489.000€). Këtu ka gjithashtu kontrata të lidhura dhe që pjesa dërmuese buxhetohen nga Ministria e Infrastrukturës.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor të performancës komunale 2024:

Bjondina Ramaj: Përshëndetje për të gjithë! Siç e dimë, matja e performancës është proces i rregullt që zbatohet nga MAPL, në bashkëpunim me të gjitha strukturat përgjegjëse të komunës: kryetarin, koordinatorin e performancës, grupin punues, si dhe autorizuesit e të gjitha drejtorive përkatëse. Të përfshira janë këto fusha: Shërbimet publike,

infrastruktura, mirëmbajtja e rrugëve, hapësirat publike, ndriçimi publik, zhvillimi ekonomik lokal, mbrotja e mjedisit, menaxhimi dhe mbeturinave, shëndetësi primare, arsimit parauniversitar, shërbime sociale, aktivitete kulturore dhe çështje të përcaktuara të shprehura me ligj. Ne si komunë, çdo vit raportojmë për 16 fusha dhe matja e këtij viti ka qenë mjaft e mirë, ku i kemi arritur rreth 80%.

Defrim Kafexhiu: Sa është përqindja në krahasim me vitin e kaluar?

Lirigzon Kastrati: Faleminderit përgjegjëses për raportimin! Tri fusha që janë sfiduese sipas këtij raporti është arsimit parauniversitar, i cili është i vlerësuar me 56%, zhvillimi ekonomik lokal dhe transporti publik. Më intereson se si janë matur këto dhe çfarë veprime do të merrni në të ardhmen për përmirësimin e këtyre tri kushteve?

Bjondina Ramaj: Kemi qenë 75%, tani jemi 80.73%. Do të thotë ka rritje dhe jemi mjaft mirë pothuajse në të gjitha fushat, përveç Hartës Zonale. Te Lirigzoni: Te transporti publik jemi 100%, por ju e keni lexuar te raporti i performancës në total, në nivel Kosove. Te raporti ynë është 100%, sepse ne e kemi edhe planin e transportit lokal publik.

Kryetari: Përshëndetje për të gjithë! Bjondinë, nëse ka mundësi ta elaboroni fushën e arsimit, cilët janë indikatorët? Më bëri përshtypja kjo % në arsim.

Bjondina Ramaj: Këtu i kemi disa indikatorë: Shkolla me masë të efijencës, ku i kemi 58.13% (renovim). Siguria e arsimit parauniversitar është 100% (rrethimi i oborreve të shkollave), plotësimi i kushteve me mjete në arsim 70% (pajisje mësimore). Te fëmijët që vijnë kopshtin nëpër fshatra, vitin e kaluar e kemi pasur 0%, tani e kemi 53%.

Kryesuesi: Faleminderit, Bjondina Ramaj! Atëherë, e përfunduar edhe pikën e tretë!

Kryetari: I nderuar kryesues, anëtarë të kuvendit, drejtorë të drejtorive, nënkryetar, përfaqësues të mediave. Kjo është seanca e fundit për këtë mandat 4-vjeçar dhe unë besoj që pothuajse të gjitha çështjet që kanë qenë në planifikimin e ekzekutivit, janë diskutuar gjerë e gjerë këtu në kuvendin e komunës. I falënderoj të gjithë anëtarët e kuvendit dhe veçanërisht ata që kanë kontribuar me debate produktive dhe ndonjëherë edhe me përplasje verbale. Kuvendi i komunës ka luajtur një rol të jashtëzakonshëm në adresimin e çështjeve dhe në zgjidhjen e tyre, sepse janë qindra vendime të votuara. Kjo është seanca e fundit dhe do të ishte e pandershme të mos merrni pjesë. Ata që janë kualifikuar për 4-vjeçarin e ardhshëm, ju uroj nga zemra. Ka edhe prej tyre që nuk janë përfshirë në listë, por nuk i dihet, sepse uji nën urë mund të hyjë e të del. Shpresoj që në të ardhmen, kuvendi dhe ekzekutivi do të punojnë për të mirën e qytetarëve të komunës së Rahovecit. I falënderoj kolegët e mi bashkëpunëtorë, prej nënkryetarit e drejtorëve. E falënderoj edhe Bjondinën që është Koordinatorë e Performancës Komunale. Ne e presim një lajm të mirë, që jemi përfitues të grantit të performancës. Afrim Limani ka vendosur që sot të kemi edhe një drekë, nuk po e them që është lamtumirë, sepse si ka thënë Hashim Thaqi “Ne mund të themi mirupafshim, por jo lamtumirë, sepse lamtumirë i thuhet atyre që nuk kthehen më”. Një pjesë do të kthehemi, shpresoj që edhe unë do të jem bashkë me ju. Suksese për të gjithë!

Kryesuesi: Për dallim nga kryetari, unë jam me letër! I nderuar kryetar, nënkryetar, drejtorë të drejtorive, të nderuar kuvendarë, media, monitorues, zyrtarë komunalë. Sot, 5 nëntor 2025, jemi pak para përfundimit të seancës së fundit të legjislaturës së tanishme, andaj dua t’ju drejtohem me një fjalim falënderimi të singertë, të gjithë juve dhe qytetarëve të komunës së Rahovecit. Me 17 vota “pro”, më 17 korrik të vitit 2023, më nderuat duke më zgjedhur kryesues të këtij kuvendi. Ishte emocion dhe përgjegjësi e madhe, gjithashtu një mundësi e jashtëzakonshme për t’i shërbyer qytetin tonë, për të kontribuar në punët e rëndësishme të kuvendit komunal, të cilat kanë ndikuar direkt në përmirësimin e jetës së qytetarëve, si dhe personalisht për t’u ngritur në karrierë. Gjatë kësaj periudhe, kemi pasur sfida, diskutime, debate dhe ndonjëherë ia kemi marrë edhe inatin njëri tjetrit politikisht, por asnjëherë personalisht. E mira e përbashkët është që kemi votuar shumë vendime të rëndësishme për komunën tonë. Falënderoj secilin prej asambleistëve për bashkëpunimin dhe për respektin e treguar gjatë kësaj periudhe. Falënderoj veçanërisht kryetarin Smajl Latifi, sepse falë propozimit të tij dhe të nëndegës së Krushës së Madhe u bëra kryesues dhe udhëhoqa secilën seancë me përkushtim dhe në mënyrën më të mirë të mundshme. Falënderoj gjithashtu nënkryetarin e komunës,

Fatmir Iskën, një njeri i rrallë dhe konstruktiv. Nëse gjatë udhëheqjes së seancave të KPF-së dhe të kuvendit ndonjëherë kam anuar në një rrënjë apo tjetër anë, sinjerisht ju kërkoj falje. Jemi njerëz dhe gabimet janë të pashmangshme, sidomos në një legjislaturë ku puna nuk u ndalë asnjëherë. Edhe pse kjo është seanca ime e fundit si kryesues i këtij kuvendi, unë do të mbetem gjithmonë mirënjohës për këtë përvojë dhe i përkushtuar ndaj qytetit tim. Uroj që legjislatura që po vijon të ketë sukses dhe që Rahoveci të vazhdojë rrugën e zhvillimit dhe ecjes përpara. Për punën e palodhur, nuk harroj të falënderoj edhe Sekretarinë e Kuvendit, juristët profesionistë: Skenderin, Albionin dhe Senadin, si dhe një falënderim i veçantë për zyrën ligjore, të cilët kanë qenë ndihmësit e mi kryesorë. Në fund, falënderoj qytetarët e Rahovecit, të cilët na kanë dhënë besimin dhe mundësinë të shërbejmë këtu. Sinjerisht, Arbër Zenuni, kryesues i kuvendit komunal të Rahovecit. Krejt në fund, një falënderim të veçantë ia dedikoj edhe familjes time.

Defrim Kafexhiu: Përshëndetje për të gjithë! Për qudi, sot kam pak emocione. I nderuar kryetar, nënkryetar, kryesues i kuvendit, drejtorë të drejtorive, kolegë anëtarë të kuvendit – institucionit më të lartë të nivelit komunal. Proceset demokratike po e bëjnë të veten. Kur e kemi filluar këtë rrugëtim politik, nuk e kemi menduar gjithmonë që mund të rizgjedhemi dhe të vlerësohet puna jonë se si e kemi bërë brenda kuvendit, edhe pse secili prej nesh e jep maksimumin në formën e vet të kontributit. Jam i nderuar që gjatë këtij mandate kemi rrugëtuar bashkë, sigurisht që jo me secilin kemi pasur bashkëpunim të duhur, por me shumicën dhe me ekzekutivin e kemi kaluar një kohë të mirë. Fatkeqësia e këtyre sistemeve demokratike-zgjedhore është që jo çdo herë vlerësohet puna që anëtarët e kuvendit e bëjnë, varësisht edhe si ata e shfaqin në publik. Sistemi demokratik na ndërron anën, por jo edhe qëllimin e përbashkët me disa nga kolegët e mi. Ju falënderoj sinjerisht! Pasi kryesuesin e përmendi, e falënderoj gjithashtu edhe unë këtë strukturë që fillimisht më ka zgjedhur kryesues i kuvendit dhe besoj që i kam dalur në krahë atyre njerëve. Në procesin e shkarkimit, prapë ka qenë një proces demokratik dhe i falënderoj edhe ata që e kanë bërë një gjë të tillë, duke ia dhënë mundësinë kryesuesit të ri, të cilin e falënderoj, përkundër qasjes së tij që ndonjëherë nuk ka qenë korrekte. Në përgjithësi është një situatë që ia vlen të falënderoj secilin dhe shpresoj që të takohemi në rrugëtimin tone për të mirën e qytetarëve.

Lirigzon Kastrati: Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, kryesues i kuvendit, drejtorë të drejtorive, kolegë anëtarë të kuvendit komunal, zyrtarë të komunës dhe ju qytetarë të komunës së Rahovecit. Në këtë fundmandat e ndjejmë për obligim t'i falënderojmë qytetarët e komunës së Rahovecit, për besimin e dhënë dhe mundësinë që të jemi zë i tyre në këtë sallë, gjatë këtij mandate 4-vjeçar. LDK, si forcë politike me traditë të gjatë në ndërtimin e institucioneve demokratike, ka qenë dhe mbetet e përkushtuar për transparencë, llogaridhënie dhe qeverisje të përgjithshme në nivel lokal. Gjatë këtij mandati, asambleistët e LDK-së kanë dhënë kontribut të vazhdueshëm në mbrojtje të interesin publik, transparencës dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Kur është dashur, kemi qenë zë kritik, por gjithmonë me qëllim vendimmarrja të jetë në shërbim të qytetarëve të komunës sonë.

Hasan Përboqi: Përshëndetje kryesues, kryetar, nënkryetar, kolegë asambleistë, drejtorë të drejtorive, media, qytetarë. Kjo është seanca e fundit për këtë legjislaturë. Në emër të grupit të asamblesitëve, jemi munduar që gjatë kësaj legjislature t'i dalim zot zotimeve që i kemi pasur para qytetarëve dhe jemi munduar që premtimet e dhëna t'i dërgojmë në vendin e duhur. 15 anëtarët e Aleancës jemi munduar që çdo herë të jemi konstruktiv. Kemi pasur edhe përplasje, por gjithmonë demokratike dhe besoj që kanë qenë për të mirën e qytetarëve. Numri i anëtarëve që i ka pasur grupi ynë, nuk ka qenë shumica e thjeshtë (16), por me përkrahjen edhe të anëtarëve të partive të tjera jemi mundur t'i trajtojmë projektet në mënyrë të duhur, përmes vendimeve që dalin prej këtij kuvendi. Atyre që janë rizgjedhur asambleistë, i dëshiroj suksese në legjislaturën e ardhshme. Urojmë që puna dhe angazhimi i tyre të mos ndalen, ndërsa edhe për ne të tjerët që nuk e kemi marrë besimin, duhet të kemi angazhim të pandalshëm për të mirën e qytetarëve.


Bejtullah Deliu: Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, drejtorë të drejtorive, kolegë asambleistë! Përshëndetje të veçantë për të nderuarin, bacën Rasim, si një shëf i grupit në tre mandate. Të falënderoj për

angazhimin tuaj politik në PDK dhe kontributin për komunën në përgjithësi. Ky është fjalimi i fundit për këtë periudhë 4-vjeçare dhe ndoshta pak po më kaplojnë emocionet. Përndryshe, kësaj radhe nuk isha në garë dhe me shpresë që herëve të tjera prapë do të kontribuojmë në mënyra të ndryshme. Ju falënderoj të gjithëve nga secila parti, ka qenë kënaqësi që ndoshta për pika të caktuara kemi pasur shumë fraksione, mirëpo, përplasjet nuk i kemi marrë me vete, i kemi lënë në sallë dhe jashtë saj kemi qenë të edukuar dhe tamam të qytetëruar e profesionalë. Është normale që ekzekutivi kërkon kritika dhe këta që janë zgjedhur duhet të vazhdojnë me kritike, sepse kur ka kritika ka edhe punë e përmirësime. Rahoveci ka nevojë për zhvillim dhe besoj që secili që fiton në këtë garë, nuk dyshoj që do të punojë për të mirën e qytetarëve.

Kryetari: Nuk është asgjë këta që nuk janë kualifikuar. Ne mund ta bëjmë një grup joformal dhe mos të merren me këtë që kanë fituar, sepse ata merren me ekzekutivin. Ndërsa, këta që nuk kanë fituar të përgatiten që t'i zëvendësojnë shumë shpejt këta që kanë fituar tani. Ju them haptas që Rasimi kam pasur qejf të jetë asambleist, gjithashtu edhe Ilir Pallqa, i cili ka hyrë guximshëm me statusin e të pavarurit. Ndërsa Defrimi është dashur të jetë bartës i listës, por nuk e di çka ndodhi!

Kryesuesi: Faleminderit kryetar! Ju falënderoj të gjithëve për bashkëpunimin, suksese në jetë! Në fund, po e bëjmë një foto për kujtim!

Procesmbajtësi:


Albion Krasniqi



KRYESUESI


Arbër Zenuni